

URDHËR
Nr. 271, datë 20.5.2026

PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT/KOMPETENCAVE NËPUNËSVE TË LARTË CIVILË TË MINISTRISË SË DREJTËSISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, për plotësimin e detyrave funksionale, i delegohen kompetencat dhe autoriteti i titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me:

a) Lëshimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim jashtë vendit të punonjësve të aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nënndarjen “i”, të shkronjës “a”, të pikës 3, të vendimit nr. 870/2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”;

b) Transferimin pa pagesë të aktiveve nga Ministria e Drejtësisë tek institucionet e varësisë dhe anasjelltas, si dhe nga Ministria e Drejtësisë tek Njësitë e Sektorit Publik dhe anasjelltas;

c) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Drejtësisë, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me përjashtim të kryerjes së procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, nën 100 000 lekë;

d) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e të gjitha letërkërkesave për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit që i përkasin juridiksionit të përgjithshëm, dhe të posaçëm penal dhe të kërkesave për informacion plotësues, në kuadër të çështjeve të ekstradimit, transferimit dhe njohjeve të vendimeve penale, për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit, përveç vendimmarrjes mbi kërkesat për transferim, si dhe njohjen e vendimeve penale dhe civile;

e) Ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, sipas nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar.

2. Urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 170, datë 19.3.2026, “Për delegimin e autoritetit/kompetencave nëpunësve të lartë civile të Ministrisë së Drejtësisë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu